



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-120/01-206905/22, më 23. 09. 2022

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), nenit 4 të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01-030/01-0210515/20, të dt. 13.11.2020 për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale, dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, merr këtë:

V E N D I M

- I. I lejohet kompensimi aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Prishtinës të deleguar nga Kryetari i Kryeqytetit, njëjtë sikurse aksionaret e deleguar nga Kuvendi i Kryeqytetit.
- II. Aksionarët do të kompensohen për çdo muaj në vlerën e pagës së përcaktuar minimale të punëtorëve në ndërmarrjet publike lokale ku të njëjtit shërbejnë, ashtu siç është përcaktuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01-030/01-0210515/20, të dt. 13.11.2020.
- III. Gjatë ushtrimit të mandatit të tyre si dhe realizimit të kompensimit, aksionaret duhet të kujdesën që të veprojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë shmangien nga konflikti i interesit.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohen Ndërmarrjet publike lokale të Prishtinës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Ndërmarrjeve publike lokale;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Aksionarëve të deleguar nga Kryetari; dhe
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama

